

**AKT THEMELIMI**  
**DHE**  
**STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**CARLOTTA SHPK**

Sot më 2 Maj 2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), në Rrogozhinë, ne të nënshkruarit:

- (i) Z. Kastriot Dema, shtetas shqiptar, lindur më 25.11.1989 në Vil, Kavajë dhe banues në Ballaj, Njësia Administrative Gosë, Bashkia Rrogozhinë, mbajtës i pasaportës me nr. BD1287057, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar; dhe
- (ii) Znj. Carlotta Dossena, shtetase italiane, lindur më 28.01.1986 në Cremona, Itali dhe banuese në Ballaj, Njësia Administrative Gosë, Bashkia Rrogozhinë, mbajtëse e pasaportës italiane me nr. YA3261938 si dhe Lejes së Qëndrimit në Republikën e Shqipërisë tipi “B” nr. 95344 datë 06.02.2016, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Statut.

**KREU I**  
**EMËRTIMI-SELIA-OBJEKTI-KOHËZGJATJA**

**Neni 1**  
**Emërtimi**

- 1.1 Shoqëria është krijuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Emërtimi i shoqërisë është Carlotta shpk (në vijim e quajtur “Shoqëria”). Shoqëria do e fitojë personalitetin juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- 1.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (“Ligji tregtar”), legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe me këtë Statut.
- 1.3 Emri tregtar mbi të cilin Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj do të jetë “Pepedoro”.



## **Neni 2**

### **Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Prona nr. 123/19/1, ZK nr. 3774, Fshati Ballaj, Njësia Administrative Gosë, Bashkia Rrogozhinë, Shqipëri.
- 2.2 Shoqëria mund të krijojë degë, zyra, filiale dhe të zhvillojë aktivitetet në vende të tjera, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me vendim të ortakëve të Shoqërisë.

## **Neni 3**

### **Objekti i Shoqërisë**

- 3.1 Shoqëria ka për objekt dhe qëllim të saj aktivitetet e mëposhtme: Veprimtari në fushën e agroturizmit, aktivitete turistike, shërbime ushqimi, shërbime hotelerie, shërbime argëtimi për fëmijë dhe të rritur, prodhim dhe tregtim produktesh bujqesore dhe pemësh të ndryshme, rritje dhe mbarështim i kafshëve, ofrim i kurseve të kuzhinës dhe pastičerisë, ofrim i kurseve të gjuhëve të huaja, shfrytëzim ambientesh pishina, shërbime trajnimit sportiv dhe palestër, import-eksport i mallrave dhe materialeve të ndryshme, veprimtari në fushën e ndërtimit civil dhe industrial si dhe tregtimit të materialeve të ndërtimit, shitje dhe tregtim me shumicë e pakicë i artikujve ushqimorë dhe industrialë, shërbime estetike dhe parukerie, veprimtari në fushën e pasurive të paluajtshme, prodhim dhe tregtim i energjisë së rinovueshme.
- 3.2 Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

## **Neni 4**

### **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- 4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohet me vendim të asamblesë së ortakëve në përputhje me dispozitat e këtij statuti dhe legjislacionin në fuqi.



## KREU II KAPITALI

### Neni 5 Kapitali


- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë i ndarë në dy kuota, me vlerë nominale 50 (pesëdhjetë) Lekë secila. Kapitali themeltar mund të rritet dhe është tërësisht i nënshkruar dhe shlyer nga ortakët.
- 5.2 Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali themeltar, pasuri të luajtshme dhe paluajtshme që janë të nevojshme në kryerjen e aktivitetit të Shoqërisë.
- 5.3 Kuotat e kapitalit derdhen nga ortakët në llogarinë bankare të shoqërisë si dhe regjistrohen në librin e llogarisë së shoqërisë.
- 5.4 Kuotat janë të transferueshme sipas kushteve të përcaktuara në Ligjin Tregtar dhe në këtë Statut.
- 5.5 Përgjegjësia e ortakëve kufizohet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

### Neni 6 Ortakët dhe kontributet

- 6.1 Ortakët e shoqërisë janë si vijon:
- **Z. Kastriot Dema**, shtetas shqiptar, lindur më 25.11.1989 në Vil, Kavajë dhe banues në Ballaj, Njësia Administrative Gosë, Bashkia Rogozhinë, i cili zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë;
  - **Znj. Carlotta Dossena**, shtetase italiane, lindur më 28.01.1986 në Cremona, Itali dhe banuese në Ballaj, Njësia Administrative Gosë, Bashkia Rogozhinë e cila zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë.
- 6.2 Kontributi i ortakëve në kapitalin e Shoqërisë mund të jetë në para ose në natyrë, si pasuri të luajtshme, të paluajtshme apo të drejta.

### Neni 7 Transferimi i kuotave

- 7.1 Kuotat e kapitalit mund të transferohen tek palët e treta në përputhje me dispozitat e këtij Statuti si dhe legjislacionit në fuqi.
- 7.2 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;



- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

7.3 Vendorsja e kuotave si mjet garancie për sigurimin e kreditimeve të ndryshme do të kryhet vetëm në sajë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë.

7.4 Nëse njëri nga ortakët dëshiron t'i shesë, transferojë apo në ndonjë mënyrë tjetër t'i disponojë ndonjë apo të gjithë kuotat e tij (kjo palë do të quhet "Shitësi"), ortakët e tjerë (Pranuesi/t i Ofertës) do të kenë të drejtën e përparësisë në blerjen e kuotave. Çdo Pranues i Ofertës do të ketë një afat prej tridhjetë (30) ditëve nga momenti i njoftimit të Shitësit. Nëse Pranuesi i Ofertës dështon në dhënien e njoftimit të blerjes brenda këtij afati, ai do të konsiderohet se ka refuzuar t'i blejë kuotat dhe Shitësi do të jetë i lirë t'i shesë këto kuota çdo pale të tretë.

## Neni 8

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 8.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- 8.2 Kapitali mund të zmadhohet me anë nënshkrimit dhe shlyerjes së kontributeve të reja nga ortakët ekzistues si dhe nga ortakë të rinj.
- 8.3 Pranimi i ortakëve të rinj në shoqëri do të bëhet vetëm me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

## Neni 9

### Zvogëlimi i kapitalit

- 8.4 Zvogëlimi i kapitalit do të bëhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Në çdo rast, vlera e kapitalit të shoqërisë nuk mund të bjerë nën minimumin e parashikuar nga ligji.
- 8.5 Propozimi për zvogëlimin e kapitalit duhet t'i paraqitet kontabilistit të certifikuar dhe Administratorit të shoqërisë të paktën 45 ditë para marrjes së vendimit nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Kontabilisti i certifikuar dhe Administratori pasi të shqyrtojnë propozimin do të përgatisin raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet për zvogëlimin e kapitalit.
- 8.6 Zvogëlimi i kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.



KREU III  
ORGANET E SHOQËRISË

**Neni 10**  
**Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë.
- 10.2 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorit/ëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesit/ve dhe të ekspertit/ëve kontabël të autorizuar;
  - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori/ët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.

**Neni 11**  
**Marrja e Vendimeve të Asamblesë**

- 11.1 Asambleja e përgjithshme thirret nga Administratori nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike i dërguar të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 11.2 Asambleja vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës kur janë prezentë ortakët që zotërojnë jo më pak se 30% të kuotave, me përjashtim të rasteve kur ligji ose statuti parashikojnë një shumicë më të lartë.
- 11.3 Çdo ortak ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.

**Neni 12**  
**Administratori**



- 12.1 Shoqëria mund të administrohet nga një ose më shumë administratorë, të cilët emërohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- 12.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë dhe të kryejë veprimet e menaxhimit të përditshëm të Shoqërisë në përputhje me urdhërat dhe udhëzimet e Asamblesë së Ortakëve.
- 12.3 Administratori i shoqërisë Carlotta shpkdo të jetë Znj. Carlotta Dossena, shtetase italiane, lindur më 28.01.1986 në Cremona, Itali dhe banuese në Ballaj, NJA Gosë, Bashkia Rrogozhinë, mbajtëse e pasaportës me nr.YA3261938 si dhe Lejes së Qëndrimit në Republikën e Shqipërisë tipi "B" nr. 95344 datë 06.02.2016, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 12.4 Afati i emërimit të Administratorit është për një periudhë 5-vjeçare me të drejtë ripërtëritje.
- 12.5 Administratori ka të drejtat dhe kompetencat e mëposhtme:
- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - f) të nënshkruajë marrëveshje me palë të treta për dhe në emër të kompanisë;
  - g) të punësojë dhe shkarkojë punonjësit e shoqërisë ose çdo person tjetër që mund të konsiderohet i nevojshëm për zhvillimin e biznesit në Shqipëri;
  - h) të vendosë për hapjen e një dege të shoqërisë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - i) të përfaqësojë shoqërinë përpara çdo banke të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë si dhe të kryejë çdo lloj transaksioni në emër të shoqërisë;
  - j) të kryejë çdo veprim që konsiderohet i nevojshëm për biznesin në Shqipëri në përputhje me urdhërat dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.



6

KREU IV  
VITI FINANCIAR

**Neni 13**  
**Viti Financiar dhe pasqyrat financiare**

- 13.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari i çdo viti dhe përfundon më 31 Dhjetor.
- 13.2 Përfundimisht, viti i parë financiar i veprimtarisë së shoqërisë do të fillojë nga data e regjistrimit dhe do të përfundojë më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 13.3 Bilanci vjetor i shoqërisë depozitohet në organet tatimore deri në fund të Marsit të vitit pasardhës ushtrimor. Llogaritë financiare mbahen në gjuhën dhe monedhën shqiptare. Për veprime të veçanta, shoqëria mund të kryejë veprime në monedhë të huaj.

**Neni 14**  
**Fitimi dhe Dividentët**

Fitimet që rezultojnë nga pasqyrat financiare të miratuara rregullisht, do të shpërndahen midis ortakëve në përputhje me kuotat e zotëruara, përveç rasteve kur është vendosur ndryshe nga ortakët në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme. Fitimi që mund të shpërndahet tek ortakët konsiston në fitimin e vitit aktual, fitimin e realizuar në vitet e kaluara dhe të mbartur, fitimi i realizuar i cili ishte destinuar për rezervën ligjore, kur qëllimi i rezervës është përmbushur dhe ortakët vendosin të shfuqizojnë rezervën në fjalë.

KREU V  
KONTROLI KONTABËL

**Neni 15**  
**Kontrolli**

Nëse kërkohet nga ligji, eksperti dhe/ose ekspertja emërohen nga asambleja. Asambleja mund të riemërojë të njëjtin/ët ekspert/ë. Eksperti/ët shkarkohet/n me vendim të asamblesë së ortakëve në rast mosrespektimi të detyrës së tij, në rast gabimi dhe në rast mungese profesionalizmi në sjellje.

KREU VI



## PRISHJA DHE LIKUJDIMI SHOQËRISË

### Neni 16

#### Prishja dhe likuidimi i shoqërisë

- 16.1 Asambleja e ortakëve mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me likuidimin e saj.
- 16.2 Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi dhe gjatë likuidimit togfjalëshi “në likuidim e sipër” duhet të vendoset para emrit të Shoqërisë.
- 16.3 Likuiduesi/t do të emërohet me vendim të Asamblesë së ortakëve. Emërimi i likuiduesit/eve dhe procesi i likuidimit do të kryhen në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar.

### Neni 17

#### Ligji i zbatueshëm dhe Juridiksioni

- 17.1 Për çështje të paregulluara në këtë Statut do të zbatohet Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- 17.2 Çdo konflikt, divergjencë, mosmarrëveshje apo pretendim i çfarëdolloji, sidoqë të ketë lindur nga apo në lidhje me këtë Statut, do të drejtohet dhe zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

### Neni 18


#### Dispozita të fundit

Ky Statut i Shoqërisë “Carlotta shpk” u hartua në katër kopje në gjuhën shqipe.



**Z. Kastriot Dema**

ORTAKËT



**Znj. Carlotta Dossena**